

Dokumenti
Nr. 1110
Data 19.09.2022
Datum

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic**

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.08.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyrytar për komunitete, drejtoret komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Festina Preniqi, zyrtare për marëdhënie me publikun, përf. i IZHL-së, dhe përf.e OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtari më i vjetër i Kuvendit, i cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

- 1. Arsyetimi për mungesë**
- 2. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre**
- 3. Shqyrtimi i kërkesave**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi sipas kërkesës së DEFZH-së, të ndryshet dhe plotësohet rendi i ditës, që në pikën 3 të përfshihet transferi i mjeteve në projektin e bashkëfinancimit.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për, 1 votë kundër dhe 6 vota abstenim e aprovuan rendin e ditës me ndryshimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DSHPE-ja, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre.

Enver Gashi – Ne jemi që kjo Draft Rregullore të dalë në debat publik dhe pasi të kthehet nga debati publik, ne si anëtarë të Kuvendit të japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo Draft Rregullore të shkoj në debat publik me lutjen që mundësishët në këto debate të përfshihen sa më shumë edhe përfaqësuesit e bashkësive fetare, në mënyrë që ata më së shumti kanë mundësi me na dhënë kontribut që kjo Rregullore me qenë sa më efikase. E kam edhe një lutje tjetër, në këtë rast drejtori që e ka dërgue kërkesën sepse kërkesat po na vijnë me gabime të mëdha drejtëshkrimore. Në një kërkesë të tillë prej 2 rreshtave janë 9 gabime drejtëshkrimore. Kryesuese, është mirë me ua kthye këtyre drejtorëve që nuk po dijnë me shkrue, me iu thënë të paktën se Kuvendi nuk është ndonjë organ çkado qoftë dhe me bë një shkresë pak më normale. Nuk shkruhet “debatë publik” me shkronjën ë në fund dhe shumë gabime tjera, kështu që është për keqardhje.

Ajet Berisha – E paraqes edhe përkrahjen time për daljen në debat publik të kësaj Draft Rregulloreje me një sugjerim se nuk do të marrë pjesë në këto debate sepse dihet se janë kogja shumë formale në rast se nuk organizohen mirë. Sugjerimi im është për drejtorin dhe për atë që e kanë sjellë Rregulloren, që më heret e kemi pasë një propozim rrith pagesës së anëtarësisë për qytetarët e Obiliqit ndaj Bashkësisë islame të Komunës së Obiliqit. Do të thotë kishte me qenë mirë me u përfshi në këtë Rregullore sepse një vullnet i kuvendarëve ka qenë, ndërsa Nënkyetari e ka mbështjellë, jo me Kryetarin e Bashkësisë islame. Eshtë momenti në rast se është vullneti i Kuvendit dhe i kësaj udhëheqësie me përfshi në kuadër të kësaj Rregulloreje, që kishte me qenë mirë pagesa e anëtarësisë së qytetarëve ndaj Bashkësisë islame.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 21 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre.

Pika 3 e rendit të ditës

Zarife Behluli – Së pari ju kërkoj falje anëtarëve të KPF-së, që nuk kam mund me mbërrri me ardhë me ua sqarue sepse e kam pasë një raport për thesar me urgjencë me kthye. Mirëpo, unë kur erdha në sallë të Kuvendit, ju veç e kishit përfundue takimin. Në bazë të marrëveshjeve, memorandumeve të lidhura nga grandi i performancës që jemi përfitues prej 808,000 €, janë 3 projekte që Komuna e Obiliqit duhet me bashkëfinancue, që është fat i madh që ne i kemi përfitue këto mjete. Në vitin e kaluar kur është bë buxheti dhe është aprovuar buxheti, ne nuk e kemi ditë se kemi qenë përfitues me vlerë aq të madhe të mjeteve nga grandi i performancës. Prandaj, ka lind nevoja që të rritet vija e bashkëfinancimit për me bashkëfinancue me këto 3 projekte. Kemi edhe 2 projekte me thirrje publike nga MAPL-ja, për komunitete, që edhe këtu Komuna bashkëfinancon. Një projekt është me Federatën e futbollit që pritet me u lidhë dhe një projekt tjetër me OSBE-në, infrastrukturë rrugore. Do të thotë janë 7 projekte që pritet me u bashkëfinancue dhe kjo është arsyja që ne e kemi paraqitë kërkesën me rritë vijën e bashkëfinancimit. Nga blerja e inventarit kanë mbetë mjete të lira 1,058 €, ndërtimi i objekteve dhe renovimi i hapësirave për komunitetin 60,000 €, furnizim me kontejnerë 206.60 €, dhe nga kodi i kogjenerimit 88.708.60 €. Pasi që ky është projekt shumëvjeçar procedurat e Prokurimit janë në tenderim, e kemi parë të arsyeshme që nga këto linja buxhetore të merren këto mjete dhe total me kalue në bashkëfinancim 150,000 €.

Enver Gashi – Së pari kjo është një e mirë, është një sukses i Ekzekutivit që i ka kryer punët qysh duhet dhe është marrë grundi. Tash, ne si anëtarë të Kuvendit mund ta japim kontributin tonë që ky bashkëfinancim gjithqysh të shkoj. Urojmë që edhe herave tjera, të kemi këso grande dhe jemi për marrjen e këtij vendimi.

Sami Ahmeti – Faleminderit prej drejtoreshës për shpjegimin sado që më duket pak i mangët, ose unë nuk i kuptoj shumë këto shifra në ekonomi. Gjithsesi se i përmendi 3 projekte në të cilat do të bëhet bashkëfinancimi, ndërkohë që nuk i përmendi se cilat janë ato. Përveç asaj i përmendi 2, ose 3 tjera që i përmendi me emra, por 3 projektet kryesore nuk i përmendi dhe neve na kish interesue me ditë se cilat janë ato. Përveç asaj kur është përfitue ky grand, përfaktin se kjo kërkesë na erdhi aq me urgjencë dhe nuk patëm mundësi me trajtue fare, pse bash në momentet e fundit kur dihet se grundi nuk është fitue një ditë para se të mbahet KPF-ja. Gjithsesi edhe këto shifra që janë të përshkruara këtu, në transfer nga projektet nuk bëjnë 150,000 €, bëjnë pak më pak. Në ekonomi dhe në institucione nuk punohet paushall, do të thotë këto shifra që ju i keni listue në 4 rreshta bëjnë 149,973 €. Unë e di se përafërsisht është ashtu, por është dashtë të shkruhet përfundi se do të transferohen përafërsisht 150,000 €.

Ajet Berisha – Nuk është shqetësim mjetet e mbetura, do të thotë ato normal duhet gjithë të trajtohen. Shqetësim është marrja e mjeteve nga kogjenerimi që është me interes të jashtëzakonshëm për qytetarët dhe që për neve asgjë nuk është konkrete. Marrja e mjeteve nga kjo linjë dhe destinimi në bashkëfinancim për 3 projekte enigmatike për të cilat ne nuk po e dijmë se për çka është fjala, e keni votën kundër për shkak të mungesës së vullnetit me na i sqarue se cilat janë ato projekte.

Ibush Mjekiqi – Drejtoresha i përmendi, por unë do ti them me emra se cilat janë projektet që janë duke u zhvilluar dhe janë në procese te Prokurimit.

Është rruga në Breznicë “Rizah Krasniqi” që është me grand të performancës, që është një projekt i madh me vlerë deri në 200,000 €. Projekti i dytë i bashkëfinancimit është blerja e pasisjeve për nevojat e kompanisë “Kastrioti” që është shumë e madhe e mjeteve përfurnizim me pajisje për këtë kompani në vlerën prej 560,000 €. Projekti i tretë është ndërtimi i urës në Grabofc, që dihet se ka pasë vërvshime para një viti e gjysmë dhe janë renovue urat, që edhe ky është projekt i madh. Projekt tjetër është ndërtimi i rrugës në Plemetin, zona mbi hekurudhë. Po ashtu, në Plemetin është edhe rregullimi i hapësirave rreth banesave kolektive, që edhe ky është projekt me bashkëfinancim. Projekti tjetër që është duke u zhvilluar dhe pritet të nënshkruhet marrveshja me Federatën e futbollit është ndërtimi i fushës sintetike të futbollit në stadionin “Agron Rama” që ne duhet të bashkëfinancojmë në vlerën prej 130,000 €.

Ajet Berisha – E para, me Federatën po të ishim qysh duhet, ish dashtë me ndërprerë këtë marrëveshje komplet. Federata ka pasë plan urgjent në vitin 2018, ne me ia dhënë hapësirat e fushës së futbollit, gjithë hapësirën që e ka klubi i KEK-ut, atje për 25 vite në shfrytëzim dhe ata me rregullue një fushë kryesore të kategorisë B dhe 2 fusha ndihmëse. Krejtë kjo, është reduktue do të thotë ajo dhënia jonë e hapësirës për 25 vite në shfrytëzim Federatës është shëndrrue në një fushë sintetike duke i anashkaluar krejtë pjesët tjera investive, që ka qenë marrëveshja. Mendoj se është e padrejtë Kryetari i Komunës me veprue kështu pa e sjellë një kërkësë çfare ka qenë marrëveshja me Federatën, pse nuk është realizue dhe a ka nevojë Kuvendi me ndryshue dhe me shëndrrue këtë interes në 130,000 €, ne me investue prapë bashkëfinancim me Federatën për një fushë sintetike. Krejtë kjo mund të jetë edhe me probleme ligjore, prandaj mendoj se Kryetari duhet me marrë mundin dhe me na i sjellë shpjegimet, a ka një ridizajnim të marrëveshjes me Federatën e futbollit të Kosovës, apo në bazë të asaj pse ka lëshue pe ky, ia kemi dhënë për 25 vjet në shfrytëzim dhe ka ardhë në një fushë sintetike ku bashkëfinancojmë. Pra, është aspekt edhe i Kuvendit dhe ligjor dhe pse ka ndodhë kjo. Pjesa tjetër, drejtoresha tha se janë 3 projekte madhore, ndërsa Nënkyetari i përmendi 5, ose 6 dhe kjo e tregon joseriozitetin e qasjes dhe vlerësimin e munguar ndaj Kuvendit. Sinqerisht është për me u habitë, ju nuk i respektoni kuvendarët e juaj sepse ata ua dhënë votën blanko, ndërsa ju nuk e merrni mundin me u angazhue dhe me iu shpjegue kuvendarëve. Mirépo, faj kanë ata se ua dhënë votën pa asnje shpjegim, kështu që LB-në, prapë e keni kundër.

Ibush Mjekiqi – Kërkoj falje, por ata që e dëgjuan drejtoreshën krejtë i përmendi këto, që i përmenda unë. Unë i përmenda specifikisht me emra, ndërsa drejtoresha e ka përmendë që është grandi i performancës 800,000 €, ku përfshihen 3 projekte. Po ashtu, janë 2 projekte tjera në Plemetin, që i përmenda unë, ndërsa drejtoresha i përmendi me thirrje publike, që unë e dëgjova, por nuk i specifikoi. Drejtoresha të gjitha projektet i ka përmendë dhe po ashtu, e përmendi edhe një projekt tjetër me USAID-in, që do të investohet në rrugë, por ky ende nuk është finalizue. Sa i përket ndërtimit të fushës, ne nuk kemi heqë dorë nga ndërtimi i stadionit “Agron Rama” në Obiliq, që ka qenë i paraparë prej 6,000 deri në 10,000 shikues dhe për shkak të vullnetit të Federatës, për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhë në Federatë dhe për shkak të fatkeqësisë natyrore që vdiq i ndjeri, ai projekt kryesor është bartë dikund tjetër. Unë jam shumë i bindur se qysh kam unë informacione, ke edhe ti. Prandaj qysh e kemi thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme për dhënien në shfrytëzim, po ashtu shumë shpejtë edhe kjo Rregullore do të ridizajnohet, ose do të hudhet poshtë nëse është e nevojshme edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme.

Ajet Berisha – Ne po kërkojmë shpjegim prej Kryetarit, pse me investue mjete ne pa u sqaru kjo punë e Kryetarit me Federastën.

Ibush Mjekiqi – Ky është hapi i parë, bisedimet janë dhe unë këtu, nuk mund ti shpalos se deri ku janë, por në finalizimin e marrëeshjes me Federatën, do ta kemi edhe këtu dhe nëse, është e nevojshme e thërrasim një mbledhje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 8 vota kundër e apreovuan Vendimin për transferin e mjeteve në projektin e bashkëfinancimit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se nuk kemi pasë asnë kërkesë nga palët për ta shqyrtuar, kështu që vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Në mbledhjen e KPF-së, z.Sami Ahmeti i ka paraqitë 2 kërkesa dhe njëra ka qenë për drejtorin e DPUKP-së, por drejtori z.Arben Berisha, ka kërkuar mirëkuptim se përgjegjet e nevojshme do të jepen në mbledhjen e shtatorit sepse është në pushim. Ndërsa, sa i përket drejtorit të Arsimit pyetjet menjëheё pas mbledhjes së KPF-së, i kam adresuar në Drejtorinë përkatëse, por nëse mundet Nënkyretari me u përgjegjë në pyetjet e z.Sami Ahmeti, për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor dhe a janë furnizue me lëndë djegëse të gjitha shkollat.

Ibush Mjekiqi – Drejtori është në një takim dhe të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor janë bërë, sidmos furnizimi me dru veç ka përfundue. Po ashtu, është në procedurë edhe furnizimi me pelet sepse këtu, bëjnë pjesë edhe institucionet parashkollore, ambullantat etj. Këtë javë ka përfundue një kontratë përenovim, që është procedue me kohë dhe arsyeva pse është vonue deri më tanë është për shkak të operatorëve, derisa janë kthye përgjegjjet nga OSHP-ja. Kontrata është lidhë dhe gjatë muajit shtator do të përfundon procesi i renovimit, aty ku ka nevojë.

Ajet Berisha – Unë dua ta paraqesë një shqetësim që me gjasë nuk është vetëm shqetësim i imi, por është i të gjithë qytetarëve të Obiliqit, çështja e reduktimeve. të rrymës. Mendoj se ne nuk duhet të kërkojmë mrekulli, por po e japë një informacion psh dje në Obiliq, kemi pasur 6 orë redukttime prej orës 6 të mëngjesit deri në 12. Në një fshat të Vushtrisë Vilancë, Novo sellë, Dumnicë, asnë orë nuk ka pasë redukttime. Ne përveç, që po kërkojmë drejtësi në kuptimin e reduktimeve, ne kemi edhe një ligj i cili Komunën e Obiliqit, që është 1 % shpenzues e futë në një kategori specifike siç janë emergjencia, AKI-ja, spitalet dhe policia, që është dashtë kjo me qenë e kundërtë me regionin që e përmenda. Nuk jam prej atyre që me ua ndalë, ose jo por kjo padrejtësi në raport me Komunën e Obiliqit, vërtetë është se nuk kemi qeverisje e cila këmbëngulë dhe e mbron interesin e vet. Kryetari i Komunës, e ka një letër në dorë që atë letër e ka marrë në vitin 2018, ose 2019 që kanë marrë zotim se do ta zbatojnë ligjin. Komuna e Obiliqit është veç në kategoritë emergjente dhe atëherë kur nuk ka asnë zgjidhje tjetër ka me pasë reduktim të rrymës, ndërsa te ne po ndodhë e kundërtë. Një Komunë tjetër nuk ka reduktime të rrymës, e Komuna jonë 6 orë. Mendoj se ish dashtë me qenë shqetësim për juve si qeverisje dhe me u takue me KEDS-in, që këtë punë me sqarue.

Valbonë Beka – Pyeti pse nuk po respektohet ligji, ose Rregullorja kur ndërtohen objektet banesore me u respektue 60 me 40 %, ku janë zonat e gjelbëruara.

Sami Ahmeti – Faleminderit për shpegin min i nderuar z.Mjekiqi, Përgjatë magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, respektivisht në fshatrat Milloshevë, Llazarevë dhe Mazgit i Epërm, i kemi 5 nënkalime të cilat nuk mirëmbahen nga Komuna me arsyetimin se kjo përgjegjësi ju takon Ministrive. Tani, që Komunës tonë në këtë drejtim i janë shtuar kapacitetet me kompaninë “Kastrioti” dhe në këtë seancë u bë edhe transfer i mjeteve për të njejtë. Ne si LVV, kërkojmë që këto nënkalime të mirëmbahen nga kjo kompani sepse janë qytetarë të Komunës tonë që i frekventojnë ato dhe është më e vogla që ne mund të bëjmë për të. Unë nuk i shfajësoj Ministritë, por deri më tanë të paktën në Milloshevë, për këto vite që janë bërë kurrë nuk janë mirëmbajtë prej Ministrive, por janë mirëmbajtë vetëm prej qytetarëve. Është mirë që kjo kompani dhe ky Kuvend të iu jepë edhe këtë përgjegjësi që të pastrohen në formë të rregulltë. Pyetja e dytë është objektet ku ndodhen lokalet respektivisht zyra e OVL-së, UÇK-së dhe e LDK-së, çfarë statusi kanë. Sa i përket zyres së OVL-së dhe UÇK-së, janë në gjendje shumë të keqe, madje ata funksionojnë edhe pa rrymë elektrike më

tepër se një vit dhe Ekzekutivi duhet me marrë masa. Ndërsa, për të dytën zyren e LDK-së, kërkojmë informata shtesë në bazë të çfarë marrëveshjeje kjo zyre qëndron aty papagesë në ndërkohë që subjektet tjera paguajnë qira për shfrytëzimin e objekteve për aktivitete politike. Ne dojmë shpjegim sepse do të duhej që subjektet politike të trajtohen të barabarta.

Shaip Paloja – Unë kam një pyetje për DSHPE-në, ose për Drejtorinë e infrastrukturës sepse nuk e di çka është duke ndodhë me sanimin e gropave nëpër rrugë. Unë e di se para një kohe ka filluar diçka një prerje, por ka mbetë ashtu dhe që është një gjendje shumë e keqe nëpër rrugë.

Valon Svirca – Te Mazgiti i Epërm, pjesa me autostradë, qytetarët atje janë të shqetësuar se diç ka don me u investue. Për shkak se është fabrika Apollonia, e cila është njëra prej ndotjeve më të mëdha aty, qytetarët dojnë sqarim se çka do të ndërtohet aty në pjesën poshtë autostradës. E dyta, te parkingu përballë Viva Fresh-it, i është dhënë në shfrytëzim komplet kompanisë taksi “Ardi” mbi çfarë baze është bërë, a ka pasë shpallje publike, për këtë punë nuk e ka votuar ai këtë kur dihet se ka edhe kompani tjera, taksi që nuk mund të qëndrojnë aty, ose edhe qytetarë tjerë, që kanë nevojë me parkue aty.

Ajshe Haliti Pllana – Unë e kam një pyetje lidhur me objektet e dhëna në shfrytëzim që janë te hekurudha, që janë 4 në shfrytëzim aty dhe që po funksionojnë pa rrymë. Ndërsa atyre është duke iu kërkuar të paguajnë tatim, por lidhja e rrymës nuk është ende, e cila dihet që duhet të bëhet nga Komuna. Vetëm njëra prej tyre funksionon, e ka energjinë elektrike ndërsa, tjerat jo.

Ibush Mjekiqi – Sa i përket ndërtimi që ishte pyetja 40 me 60, dhënia e lejeve, këto i përkasin DPUKP-së, drejtorit z.Arben Berisha , që në mbledhjen e radhës të përgjegjet. Tani i përgjegjim z.Valon, se ne jemi në hartim të planit urbanistik se shumë shpejtë do të vijë për aprovim këtu, ashtu janë duke shkue proceset dhe ajo zonë atje, do të jetë zonë industriale, do të thotë qysh është zona tjetër në anën e djathtë. Tash, sa hektarë janë për momentin nuk e di dhe sa e di unë ende nuk është dhënë asnjë pronë aty, por është në fazë të rregullimit të territorit, pastaj përmes Kuvendit, përmes Kryetarit do të jepet në shfrytëzim varësisht prej shprehjes së interesit. Te rregullimi i rrymës, është shumë e vërtetë se ne kemi zhvilluar procedura, por për shkak të procedurave të Prokurimit të kompanive është në procedurë të lidhjes së marrëveshjes, ose të kontratës për rregullimin e orëve të rrymës në atë zonë, ose te lokalet e ndërtuara përballë hekurudhës. Te rregullimi i gropave të asfaltit, është shumë e vërtetë se gropat janë nga vitet e kaluara dhe me dt.27 maj të këtij viti, ne veç kemi lidhë kontratë për shkak të mospërgjegjësisë, për shkak të moskryerjes së punimeve ka ardhë deri te shkëputja e kontratës. Është penalizue në fillim kompania e cila nuk ka qenë e përgjegjshme me i krye punët, që neve na ka marrë kohë një muaj e gjysmë shkëputja e kontratës. Pastaj, është bërë ritenderimi dhe besoj se brenda 10 dite do të lidhet kontrata e re në mënyrë që të sanohen gropat. Tani, i përgjegjim z.Ajet Berisha, për reduktim të rrymës, që është e vërtetë se Obiliqi nuk duhet të jetë i sanksionuar me reduktim, por vërtetë ka qenë gjendja e rendë me furnizim me rrymë. Sa i përket Vushtrisë është KFOR-i, i vendosur në atë zonë në Novosellë dhe kjo është arsyaja pse atje nuk ndalet rryma, ndërsa në zonën tjetër njejtë ka qenë sikurse te ne.

Ajshe Haliti Pllana – Deshta me kërkue prej juve, derisa nuk rregullohet energjia elektrike me u shtye edhe faktura e tatimit, do të thotë mos të iu kërkohet tatimi derisa nuk e rregulloni energjinë elektrike. Pyes, qysh mundet me iu kërkue tatim dikujt derisa nuk është e rregulluar aty energjia elektrike.

Ibush Mjekiqi – Unë u përgjegja për rregullimin e orëve të rrymës dhe thashë se jemi në procedurë të lidhjes së kontratës që do të vendosen edhe orët dhe pjesa tjetër e instalimit.

Ajet Berisha – Pyeti a ka vendim Komuna për ndarje të banesave në objektet Hade e Re dhe a ka vendim për kategoritë e dala nga lufta. Në bazë të informatave njerëzit me gjysëm vendimi nga Komisioni atje, veç kanë hy. Po ashtu, a ka ndonjë veprim nga kjo Komunë që me sjellë atë vendim, që me ditë ne si kuvendarë dhe Kryetari i Komunës, a e din se kush i ka marrë ato banesa. Nëse, Nënkryetari nuk mund të përgjegjet atëherë le të përgatiten për mbledhjen e radhës, e cila do të jetë e ngarkuar sepse është buxheti, kështu që është mirë me shkrim me na dërgue.

Ibush Mjekiqi – Me ditë e di edhe sot, por le të mbetet për mbledhjen tjetër sepse po ua kursej kohën.

Sami Ahmeti – Nuk e di, të gjithë neve na kaloi kjo seancë pa e parë që nuk kemi pasë ekstrakt të procesverbalit dhe do të ishte mirë që herave tjera ti kemi, që puna jonë le ti lenë shenjat e tyre. Prej pyetjeve të mia nuk mora përgjegje, por do të iu dërgoj kërkësë me shkrim institucionit.

Kryesuesja – Sa i përket ekstrakt procesverbalit bashkëpunëtorja për punë të Kuvendit, ka qenë në pushim vjetor dhe pasi është inçizimi i mbledhjes besoj se do ta përgatitë për mbledhjen e ardhshme.

Ibush Mjekiqi – Kërkoj falje z.Sami, se ato nënkalime janë dhe unë i kam vizitue të gjitha edhe në vitin e kaluar. Në Milloshevë kemi pasë një ndërhyrje te shkolla me një OJQ, që na ka ofrue dhe nuk është bërë më e mira e mundshme, por ka probleme edhe me kanalizim. Për atë veprim aq të vogël mund të them se sado kudo i ka lehtësue nënkalimet për ata që i shfrytëzojnë, është dashtë me marrë leje prej Ministrisë së mjedisit dhe infrastrukturës. Mendoj se në një të ardhme pse mos me i marrë kompania jonë me i mirëmbajtë, por ne bashkarisht duhet me Ministrinë e infrastrukturës, të bëjmë një projekt të përbashkët, një memorandum të bashkëpunimit, në mënyrë që të bëjmë edhe një investim sepse kërkojnë investime. Mirëpo, sido që të jetë në vitin e kaluar personalisht vetë jam angazhue që nënkalimi te shkolla në Milloshevë, të jetë funksional.

Valbonë Beka – Para 2,3 muajve e kam bërë një pyetje dhe Nënkyetari më ka mbetë borxh, nuk ma ka kthye përgjegjen, fjala është për mjetet e praktikës profesionale për shkollën “Ismail Dumoshi”.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se hera e fundit që kam bisedue për këtë është të premtën e kaluar dhe ne do të bëjmë maksimumin që për këtë vit të shlyhet ai obligim ndaj arsimtarëve të shkollës profesionale, ndërsa për vitet tjera, nuk do të ketë telashe për këtë çështje.

Valbonë Beka – Pak më keqkuptve, jo vetëm nga pagesat për të rritur por fjala është për mjetet që i ka dhënë Ministria e Arsimit, për praktikë profesionale.

Ibush Mjekiqi – Për praktikë profesionale pikërisht janë këto sepse Komuna e Obiliqit, e ka një buxhet dhe nuk ka buxhet tjetër dhe ato ridestinohen kthehen në investime dhe në praktika.

Ajshe Haliti Pllana – Pasi që jemi te Arsimi, veç një lutje e kisha pasë, ju thatë se furnizimi me dru ka shkue, por unë kam informacione se vjet nxënësit e Komunës tonë nëpër fshatra kanë mësue me jakne. Përveç shkollës së Milloshevës, dikund tjetër nuk ka pasë nxemje herë pas here për shkak të numrit të vogël të nxënësve. Mirëpo, a është një apo dy nxënës, ne e kemi obligim me i pasë lëndët djegëse, që ata fëmijë me pasë një mësim normal. Unë personalisht kam fënijë vetë dhe nuk e dërgoj fëmiun tim me u mërdhi në shkollë, pse po i ruan Komuna, ose shkolla lëndët djegëse. Prandaj, ju lus shumë është heret dhe mund ta rregullojmë këtë çështje.

Ibush Mjekiqi – Gjithçka është e mundur dhe ka mund me ndodhë, por furnizimi dhe nxemja në vitin e kaluar përveç në Milloshevë, x herë ka pasë probleme teknike. Përndryshe, për çështjen e ruajtjes dhe mos me ndez dru, unë e them me sinqueritetin më të madh se nuk e kam informatën, por nëse marrë vesh unë me Ekzekutivin se po i ruajnë drutë, të jesh e bindur se do të reagoj menjëherë.

Ajet Berisha - Këtu, nuk është çështja se po i kursejnë drutë, por ose pritojnë mi ndez, ose nuk kanë dru.

Ibush Mjekiqi – Ka edhe papërgjegjësi dhe anëtarit të Kuvendit i takon me ngritë çështjen si shqetësim, ndërsa me marrë masa ndaj tij i takon përgjegjësit kryesor atje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:56'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

